

NR: 03-119/2
Shkup : 22.06.2020

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 22.06.2020, solli

MENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës shqyrtoi Kërkesën për Mendim të dorëzuar nga Ministria për Investime të Huaja Zorica Apostolska me nr. 03-119/1 të datës 09.06.2020, dhe në lidhje me aktivitetet për realizimin e projektit investues të kompanisë Kranfild Foundri SHPKNJP Shkup, me të cilën Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 29.07.2015 ka lidhur Marrëveshje për dhënie të ndihmës shtetërore me nr. 12-68/13, bazuar në Vendimin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës me nr. 10-48 dhe Aneks Marrëveshje me nr. 1 nr. 13-8462/1 të datës 05.09.2018, të lidhur në bazë të Vendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës me nr. 10-60 nga 09.08.2018.

Sipas kornizës ligjore të përcaktuar për dhënien e ndihmës shtetërore dhe Planit afarist, investitori është i detyruar të investojë së paku 20.000.000 euro dhe të punësojë së paku 100 persona në një periudhë pesëvjeçare nga data e fillimit të projektit investues, gjegjësisht nga data e lidhjes së Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore.

Kompania Kranfild Foundri SHPKNJP Shkup, më 15.05.2020 me shkrim ka njoftuar Kabinetin e Ministres së Investimeve të Huaja Zorica Apostolska se nuk është në gjendje t'i përmbush me kohë obligimet që dalin nga Marrëveshja dhe Aneks Marrëveshja nr. 1 brenda afateve të përcaktuara për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, e cila, si pasojë e ngadalësimit të ekonomisë globale, ka ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e kompanisë. Deri më 15 maj 2020, kompania ka investuar më shumë se 16,000,000 euro dhe ka punësuar 73 persona.

Duke u bazuar si më lartë, është përgatitur një propozim Aneks Marrëveshje nr. 2 me të cilin propozohet zgjatja e afateve për realizimin e projektit të investimit dhe pagesës së ndihmës shtetërore për një vit.

Komisioni thekson se në Rregulloren për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 109/13), **nuk është rregulluar periudha e projektit të investimit**. Prandaj, Komisioni vlerëson se nuk nevojitet asnjë ndërhyrje në drejtim të anulimit apo plotësimit të vendimeve ekzistuese lidhur me këtë investim.

Komisioni gjithashtu thekson se, sipas nenit 6 të të njëjtës Rregullore, **investimi duhet të mbahet për një periudhë të paktën pesëvjeçare pas realizimit të plotë të tij**. Gjithashtu, sipas nenit 5 të Rregullores, dhënësi i ndihmës shtetërore është i detyruar të sigurojë që intensiteti

maksimal i ndihmës rajonale për investime të mos kalojë shumën prej 50% të kostove të justifikuara të investimit.

Dhënësi i ndihmës shtetërore ka detyrim ndaj Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë raport vjetor në përputhje me Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore dhe në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e parashtrimit të njoftimit për dhënie të ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 142/11), në Formularin e dhënë si Shtojca III e Rregullores së mësipërme.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски